

LIGJ

Nr. 8937, date 12.9.2002

PER RUAJTJEN E NXEHTESISE NE NDERTESA

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka per qellim te krijojte bazen ligjore te nevojshme per vendosjen e rregullave dhe berjen te detyrueshme te marrjes se masave per ruajtjen e nxehtesise ne ndertesate.

Neni 2

Per qellimet e ketij ligji, termat e perdorura kane keto kuptime:

"Ndertese" do te thote nje ngrehine, nje bashkesi lokalesh, mjedis banimi, sherbimi e prodhimi me karakter publik ose privat.

"Instalim termik" do te thote bashkesi pajisjesh termike se bashku me rrjetin lidhes, qe sherbejne per ngrohjen dhe ftohjen e mjedisit te brendshem te ndertesave.

"Ngrohje qendrore" do te thote nje impiant ngrohjeje, qe furnizon me energji termike nje ose me shume apartamente.

"Ngrohje lokale" do te thote nje impiant ngrohjeje, qe furnizon me energji termike nje grup ndertesash te ndara nga njera-tjetra.

Neni 3

Projektimi dhe ndertimi i ndertesave te realizojte parametrat teknike te nevojshem per ruajtjen, kursimin dhe perdorimin me eficence te energjise. Te gjitha ndertesat qe do te ndertohen pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, te respektojne

koeficientin vëllimor e normativ të humbjeve termike (Gv), si dhe të parashikojnë vendosjen e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore.

Neni 4

Instalimet e prodhimit të nxehtësisë (gjeneratorët e nxehtësisë ose/dhe pompat e nxehtësisë) për ngrohjen dhe/ose freskimin e ndërtesave projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm, sipas normave të komfortit të temperaturës, duke marrë parasysh kushtet klimatike zonale dhe anën funksionale të ndërtesës .

Neni 5

Këshilli i Ministrave përcakton normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.